



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 339 Regj

Lushnje, më 22.04.2022

VENDIM SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës Përmbaremore Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbaremore nr. 339, datë 06.04.2022, bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.383/1, datë 24.09.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë,

KONSTATOVA:

Se në datë 05.04.2022 është depozituar pranë Zyrës Përmbaremore Lushnje kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë së bashku me Urdhërin e ekzekutimit nr.383/1, datë 24.09.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, me palë:

- Kreditor: Prokuroria Korçë
- Debitor: Sajmir Gjergji Liçe
- Objekti: Shpenzime procedurale

Nga ana e Zyrës Përmbaremore Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor*", i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Sajmir Gjergji Liçe nuk ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për ekzekutimin e Urdhërit të ekzekutimit nr.383/1, datë 24.09.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Sa mësipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor*", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunikimin postar), nga data 22.04.2022 – 12.05.2022 të debitorit Sajmir Gjergji Liçe;
2. Ky vendim përpihet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës Përmbarimore Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Sajmir Gjergji Liçe me banim në L. “Skënder Libihova”, Nj. Ad. Nr.3, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Sajmir Gjergji Liçe me banim në L. “Skënder Libihova”, Nj. Ad. Nr.3, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës Përmbarimore Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe të marr kontakte me përmbauesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 22.04.2022.

KRYETARI I ZYRËS

Endrin Kashari

